



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10.5.2023

Nr: 481

Ora: 13:30

V E N D I M

P Ë R

**VLERËSIMIN E RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË DISA
INSTITUCIONEVE DHE SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 343 ID, 344 ID,
342 ID, 345 ID, TË DEPUTETIT ZJ. ALBANA VOKSHI, NR. 361 ID, 362 ID, 363 ID, 355 ID, 356
ID Z. IVI KASO, DHE 348 ID TË KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE
TË KONSOLIDUARA (KRIIK) PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, PËR PERIUDHËN 21 PRILL – 27
PRILL 2023**

Sot më datë 10 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës, Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshilli i Qarkut Vlorë, Bashkia Kolonjë, Bashkia Korçë, Bashkia Pogradec.

Zj. Festime Mjeshtri, kandidat për kryetar në bashkinë Bulqizë,

Zj. Emiriana Sako, kandidat dhe kryetar i bashkisë Durrës,

Z. Edison Memolla, kandidat dhe kryetar i bashkisë Rrogozhinë,

Z. Safet Gjici, kandidat dhe kryetar i bashkisë Kamëz,

Z. Kreshnik Hajdari, kandidat dhe kryetar i bashkisë Kuçovë,

Zj. Eriselda Sefa, kandidat dhe kryetar i bashkisë Lushnjë.

OBJEKT: Vlerësimi i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve si dhe shqyrtimi administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me kufizimet e nenit 91, të Kodit Zgjedhor, për periudhën 21 prill deri 27 prill 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 9.3.2021 të Komisionit Rregullator ‘Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe

Data:10.5.2023 Nr: 481
Ora: 13:30



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 21 Prill – 27 Prill 2023”

afatet e hetimit administrative të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” , si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

KREU I

Gjatë periudhës 21 prill deri më 27 prill 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike (shkresë+email), janë raportuar gjithsej 162 aktivitete, nga 50 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se nga këto, 17 aktivitete të zhvilluara nga 8 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Nga këto, janë ndaluar 7 veprimtari për Bashkinë Maliq, për shkelje të afatit të raportimit.

Për aktivitetet e raportuara në tejkalim të afatit ligjor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kryer shqyrtimin administrativ si vijon:

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet “*Ftesë për pjesëmarrje*”, raportuar në datë 24.4.2023 për tu zhvilluar në datë 27.4.2023

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këtë aktivitet për shkak se është në cilësinë e të ftuarit nga Ministria e Shëndetësisë. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

2. Ministria e Kulturës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 4 (katër) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet *“Simpozium në bashkëpunim dhe partneritet me qeveritë dhe institucionet e tjera”*, raportuar në datën 26.4.2023 për t’u zhvilluar në datën 29.4.2023,
2. Aktivitet *“Konkursi i qendrës së vizitorëve Butrint,”*, raportuar në datën 24.4.2023 për t’u zhvilluar në datën 26.4.2023,
3. Aktivitet *“Konkursi i qendrës së vizitorëve Butrint,”*, raportuar në datën 24.4.2023 për t’u zhvilluar në datën 26.4.2023,
4. Aktivitet *“për nxitjen e leximit të fëmijëve”*, raportuar në datën 23.4.2023 për t’u zhvilluar në datën 27.4.2023

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se për aktivitetin e dytë dhe të tretë, Ministria e Kulturës nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këtë aktivitet për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Në lidhje me aktivitetin e parë me tematikë *“Simpozium bashkëpunimi me qeveritë e tjera dhe institucione të tjera”*, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, përshkrimi i veprimtarisë së raportuar në ndërfaqe, konstatoi se kjo veprimtari është organizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional, për të cilën duhet marrë konfirmimi i pjesëmarrjes, fakt ky që mbahet parasysh gjatë shqyrtimit në lidhje me raportimin jashtë afatit.

Në lidhje me aktivitetin e katërt, për shkak të tematikës, *“Lexime përrallash nga aktorë të Teatrit të Kukullave, për nxitjen e leximit të fëmijëve”*, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se veprimtaria nuk përbën veprimtari publike me detyrim për raportim.

3. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti *“Mëngjese pune”*, raportuar në datë 24.4.2023 për tu zhvilluar në datë 28.4.2023

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes nëpërmjet email-it të datës 4.5.2023 ka nisur pretendimet e veta dhe ka sqaruar se: *“Më datë 28.4.2023 Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes organizoi një takim të mbyllur me të ftuar përfaqësues të ekosistemit të Start Up-eve, pa praninë e përfaqësuesve të medias. Organizmi i këtij aktiviteti kishte për qëllim ndarjen e komenteve mbi ecurinë e shqyrtimit në Komisionin për Veprimtarinë prodhuese të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 25/2022 “Për zhvillimin dhe mbështetjen e Start Up-eve”. Kjo veprimtari është në fushën e veprimtarisë së Ministrit të*

Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, si propozues i ndryshimeve ligjore në fjalë. Organizimi i kësaj seance të Komisionit për Veprimtarinë prodhuese, u njoftua nga struktura mbështetëse e Komisionit me komunikim elektronik për kabinetin e Ministrit të Shtetit, më datë 21.4.2023 për tu organizuar në datë 24.4.2023. Në këto rrethana koha për organizimin dhe raportimin e aktivitetit ishte e kufizuar.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, në përshkrimin e veprimtarisë gjatë raportimit, është theksuar se: Ministri i Shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes në kuadër të fushës së vetë të veprimtarisë do të zhvillojë një aktivitet ndërgjegjësues në lidhje me ndryshimet ligjore që janë parashikuar në ligjin 25/2022 “Për Mbështetjen dhe zhvillimin e Start Up-eve, për nomadët digjital”. Përsa më sipër vlerëson se kjo veprimtari është zhvilluar si pjesë e veprimtarive administrative funksionale të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

4. Këshilli i Qarkut Vlorë, ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “*Seminar për ngritjen e kapaciteteve në Vlorë – Projekti Resiliënza Marginale*”, raportuar në datë 25.4.2023 për tu zhvilluar në datë 27.4.2023

Këshilli i Qarkut Vlorë nëpërmjet email-it të datës 4.5.2023 ka sqaruar se: “*Në përgjigje të kërkesës tuaj mbi pretendimet në lidhje me procesin administrativ, ju bëjmë me dije si më poshtë: Aktiviteti i raportuar, i datës 27 Prill, për projektin Resiliënza Marginale, i pasqyruar në faqen e KQZ-së nga ana e institucionit: Këshilli i Qarkut Vlorë, është organizuar dhe zhvilluar nga ana e ASSET-Regione Puglia, ku Regione Puglia, është lideri i projektit dhe ky aktivitet përveçse organizohej prej tyre dhe pagesat e shpenzimeve, janë kryer të gjitha, nga ana e partnerit lider italian. Ndihmës në organizimin e aktivitetit për partnerët italianë, ishte Biznes Albania (OJF). Për këtë aktivitet pala organizuese nuk na dërgoi as agjendë, madje jemi njoftuar disi me vonesë. Të ndodhur ne këto kushte gjykojmë që të raportojmë pjesëmarrjen, madje është raportuar dhe pjesëmarrja e kryetarit në rast se do duhej të bënte ndonjë fjalë përshëndetëse, por faktikisht Kryetari nuk mori pjesë në takim. Duke qenë periudhë zgjedhore menduam që sado vonë u njoftuam, dhe të njoftuar informalisht e me vonesë, ta raportonim pjesëmarrjen tone në aktivitet. Vonesa në raportimin e aktivitetit konsistonte te fakti që ishim në pritje të agjendës së takimit, nga organizatorët. Takimi kishte natyrë informuese dhe pjesëmarrës ishin kryesisht OJF dhe fermerë, si palë të interesuara, ku u informuan me mënyrën se si funksionojnë GAL (Grupet e Aksioneve Lokale) në Itali. Pjesëmarrja e Këshillit të Qarkut Vlorë është pasi ne jemi partner në këtë projekt. Aktiviteti kishte karakter tërësisht informues, nuk hyn te aktivitetet e ndaluara, aspak me karakter politik, asnjë shenje, simbol politik, apo kandidat i ndonjë force politike nuk mori pjesë në seminar.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se Këshilli i Qarkut Vlorë, nuk është në cilësinë e organizatorit të këtij aktiviteti, pasi ky projekt, organizohet nga ASSET-Regione Puglia. Kryetari i Këshillit të Qarkut, është ftuar për të qenë pjesëmarrës, por nuk ka marrë pjesë. Në të tilla kushte, vlerësojmë se nuk jemi para kundërvajtjes administrative pasi në referim të nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

5. Bashkia Kolonjë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti *“me rastin e 5 majit”*, raportuar në datë 27.4.2023 për t’u zhvilluar në datë 5.4.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura në raportim, vlerëson se është kryer një gabim gjatë raportimit në ndërfaqe, fakt ky që provohet edhe nga tematika e raportimit të kryer *“Aktivitet me rastin e 5 majit”*. Përsa më sipër, mirëkuptohet situata dhe nuk konsiderohet si kundërvajtje administrative.

6. Bashkia Korçë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti *“Finale e konkursit të talenteve rinore “Rin Shoë”*, raportuar në datë 27.4.2023 për tu zhvilluar në datë 30.5.2023

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura në raportim, vlerëson se për shkak të tematikës, veprimtaria nuk përbën veprimtari publike me detyrim për raportim.

7. Bashkia Pogradec ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti *“Në muajin Nëntor të 2022 nisi zbatimin e projektit për trotuare dhe korsit biçikletash në aksin Pogradec-Gështenjas. Punimet janë kryer në fazën 80% dhe Kryetari i Bashkisë do inspektojë ecurinë e tyre”*, raportuar në datë 22.4.2023 për tu zhvilluar në datë 28.3.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura në raportim, vlerëson se është kryer një gabim gjatë raportimit në ndërfaqe. Për sa më sipër,

mirëkuptohet situata dhe nuk jemi para rrethanave të një kundërvajtje administrative.

KREU II

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, ka depozituar denoncimin nr. 348 ID, për të cilën pretendohet se ka shpërdorim të burimeve publike.

Deputeti zj. Albana Vokshi, ka depozituar denoncimet me regjistruar me numër 343 ID, 344 ID, 342 ID, 345 ID, për të cilat pretendohet se ka shpërdorim të burimeve publike.

Z. Ivi Kaso, ka depozituar denoncimet me regjistruar me numër 361 ID, 362 ID, 363 ID, 356 ID, për të cilat pretendohet se ka shpërdorim të burimeve publike.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është organi kompetent për konstatimin e kundërvajtjes në zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime nëpërmjet provave link të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve/denoncimeve.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me shkeljet e pretenduara nga denoncuesit nëpërmjet adresës së postës elektronike email.

Subjektet dhe institucionet e denoncuara janë si më poshtë vijon:

- 1. Denoncimet e regjistruara ndaj zj. Festime Mjeshtri**, punonjës i administratës shtetërore të Shëndetit Publik Bulqizë, për të cilën pretendohet se është angazhuar

në fushatën zgjedhor të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Për të njëjtin subjekt dhe objekt, kanë ardhur 2 (dy) denoncime të regjistruara **me nr. 343 ID**, me kërkues z. Ivi Kaso dhe me **nr. 361 ID**, me kërkues zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

- **Denoncimi nr. 361 ID**, me kërkues z. Ivi Kaso, nëpërmjet shkresës nr. 142 prot., datë 20.4.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4146 prot., datë 24.4.2023 ku pretendohet se “Punonjës të administratës shtetërore të shëndetit publik në Bulqizë janë të angazhuar në fushatën e Partisë Socialiste.
Zj. Festime Mjeshtri ka kryer takime me banorët e zonës nën siglën e subjektit zgjedhor PS, duke kryer veprimtari me qëllime zgjedhore në kundërshtim me dispozitat ligjore”.
- **Denoncimi nr. 343 ID**, me kërkues zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet ndërfaqes së denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 11146, i datës 21.4.2023, ku pretendohet i njëjti fakt si në denoncimin **nr. 361ID**.

Më datë 28.4.2023, Shërbimit Spitalor së Bulqizës i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë. Nëpërmjet shkresës nr. 193/1 prot., datë 2.5.2023 e administruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4615 prot., datë 2.5.2023 ku bëjnë me dije se:

1- Zonja Festime Mjeshtri është aktualisht punonjëse e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Bulqizë, me detyrë drejtor i këtij institucioni. (Nuk është punonjëse e Shëndetit Publik Bulqizë, pasi sipas urdhërit nr. 130 datë 12.12.2022, të DQOSHKSH Tiranë, "Për emërim të përkohshëm në detyrë, emërohet drejtor i Drejtorisë Shërbimit Spitalor Bulqizë).

2- Zonja Festime Mjeshtri kandidon për kryetare të bashkisë Bulqizë, për zgjedhjet vendore të 14 Majit 2023. Drejtoresha e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Bulqizë, zonja Festime Mjeshtri ka dërguar pranë DROSHKSH Zyra e Burimeve Njerzore Tiranë, kërkesën për leje të zakonshme, për vitin 2023. Shkresa me nr. 172 prot., datë 18.04.2023. Miratimi i kërkesës për leje të zakonshme është bërë nga ana e OSHKSH, Drejtoria Rajonale Tiranë "Miratim leje e zakonshme e paguar për vitin 2023", nga data 19.04.2023 deri me datë 17.05.2023, 28 (Njëzet e tetë) ditë kalendarike. Shkresa me nr. 962/1 prot. datë 19.04.2023. Fushata zgjedhore është bërë gjatë periudhës së lejës së zakonshme për vitin 2023, të miratuar nga OSHKSH Tiranë.

3- Në lidhje me pretendimin e denoncuesit, zonja Festime Mjeshtri ka bërë fushatë për zgjedhjet të 14 Majit 2023, gjatë kohës që ka qenë dhe është me leje të zakonshme të vitit 2023 dhe jashtë ambienteve të institucionit, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Bulqizë. Punonjësit e administratës së Drejtorisë Shërbimit Spitalor Bulqizë, nuk kanë bërë fushatë gjatë orarit zyrtar të punës. Jashtë orarit zyrtar është e drejtë kushtetuese e çdo personi të bëjë fushatë apo çfardolloj aktiviteti tjetër, në zbatim të ligjit. Ndërsa për Administratën e Shëndetit Publik Bulqizë, është drejtori me vete dhe nuk kemi varësi të ndërsjellë.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 5.5.2023, ora 12:30, ku u ftuan në këtë proces palët, duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në seancë u paraqit përfaqësuesi i Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Bulqizë, i cili gjatë seancës deklaroi se zj. Mjeshtri në asnjë rast nuk është përfshirë në fushatë zgjedhore gjatë orarit të punës dhe se gjatë kësaj periudhe ka qenë me leje të zakonshme.

Nga hetimi, rezultoi se marrëdhënia e punës së zj. Festime Mjeshtri, rregullohet nga ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë". Vetë Kodi i Punës nuk ka asnjë parashikim në lidhje me këtë kërkesë. Nisja e procedurës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ***në rastet kur nuk njoftojnë për kandidimin në zgjedhje***, është kompetencë e organit ku zj. Mjeshtri ushtron detyrën e saj. Të ndodhur në këto kushte, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ dhe çështja t'i përcillet për kompetencë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Denoncimet e regjistruara ndaj Kryetarit/Kandidatit të bashkisë Durrës, zj. Emiriana Sako, për shpërdorim të burimeve publike të institucionit në shërbim të fushatës së saj zgjedhore, veprimtari të cilat janë regjistruar me nr. 344 ID, 342 ID dhe 356 ID.

- **Denoncimi nr. 344 ID**, me kërkues zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet ndërfaqes së denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 11746, i datës 24.4.2023 ku pretendohet "*Rrulat e fadromës i parkojnë të shtabi i kandidatës për bashkinë Durrës, njëherazi edhe kryetare e bashkisë Emiriana Sako. Sipas denoncimit të ardhur, këto mjete i mbajnë në gatishmëri te shtabi i kandidatës për t'u përdorur kush ju kërkon rrugë në këmbim të votës*".
- **Denoncimi nr. 342 ID**, me kërkues zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet ndërfaqes së denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 11750, i datës 24.4.2023 ku pretendohet "*Zj.Emirjana Sako (Kryetarja e bashkisë Durrës dhe kandidatja e PS), ka organizuar takime elektorale me nxënës të arsimit parauniversitar. E ka deklaruar vetë publikisht. Denoncimet e qytetarëve dhe nxënësve na tregojnë se i kanë nxjerrë me herët nga mësimi.*"
- **Denoncimi nr. 356 ID**, me kërkues z. Ivi Kaso, nëpërmjet shkresës nr. 150 prot., datë 26.4.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4236 prot., datë 26.4.2023 ku pretendohet i njëjti fakt si në denoncimin nr. 342 ID.

Sipas denoncuesit, shkelja e mësipërme është shkelje flagrante e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Për denoncimin me Denoncimi nr. 344 ID:

Më datë 28.4.2023 bashkia Durrës sqaron në lidhje me denoncimin nr. **344 ID** se *“Bazuar në ligjin 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, në nenin 23, përcaktohen funksionet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike ku ndër të tjera thuhet se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:*

“Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore”.

Këto janë detyra funksionale të Ndërmarrjes Rrugë të cilat ushtrohen në çdo kohë, në çdo rrugë të qytetit dhe njësive administrative pavarësisht jemi në fushatë zgjedhore apo jo. Gjithashtu nga komunikimi me email me drejtorin e Ndërmarrjes Rrugë informohemi që :

Ndërmarrja Rrugë Durrës, institucion në varësi të Bashkisë Durrës mban të angazhuar mjetet që shërbejnë për mirëmbajtjen e rrugëve (trotuareve, rrugë kalimi), ndriçim, sinjalistikë, gjelbërim, pastrimin e kanaleve të hapura të rrjetit ujor. Pjesë të mjeteve janë kamione, rrul, autokulla, asfaltoshtruse, kamionçina, fadroma, eskavator, bote uji. Lëvizja e mjeteve kryhet sipas planit të punës të paracaktuar. Mbas përfundimit të detyrave për secilin sektor, gjatë ditës, të gjitha mjetet që ne kemi në pronësi stacionohen në parkun e automjeteve të Ndërmarrjes Rrugë. Punimet realizohen sipas parashikimeve buxhetore të miratuara nga Këshilli Bashkiak Durrës për çdo sektor, pjesë të Ndërmarrjes Rrugë. Gjithashtu ju informojmë se punimet në rrugët nuk kryhen vetëm nga Ndërmarrja Rrugë, por dhe nga operatorë ekonomikë që rezultojnë fitues në procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga Bashkia Durrës në zbatim të buxhetit të bashkisë ose/ dhe FSHZH.

Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me **denoncimin nr. 344 ID**, vlerësoj se: Referuar nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”*. Referuar kthimit të përgjigjes së bashkisë Durrës, *Ndërmarrja Rrugë Durrës, institucion në varësi të bashkisë Durrës, ka qenë në përbushje të detyrave të veta funksionale. Gjatë hetimit nuk u konstatua përdorimi i burimeve publike në funksion të fushatës së zj. Emiriana Sako.*

Për sa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ për denoncimin me nr. 344 ID duke mos konstatuar shkeljen e pikës 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

Për denoncimin nr. 342 ID dhe denoncimi nr. 356 ID:

Më datë 26.4.2023 Zyrës Arsimore Parauniversitare Durrës dhe bashkisë Durrës i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 4.5.2023, Zyra Arsimore Parauniversitare Durrës ka sqaruar se “ZVA është në dijeni të realizimit të një takimi me nxënës të arsimit të mesëm të lartë, në kuadër të diskutimit për politikat zhvillimore për të rinjtë në rreth, me kryetaren e bashkisë Durrës. Dimë që për pjesëmarrjen e të rinjëve në këtë takim ka qenë një thirrje e hapur. Takimi është realizuar respektivisht në orën 13:30, orar kur ka përfunduar procesi mësimor për shkollat që zhvillojnë mësimin në turnin e parë dhe në orën 18:00 dhe 19:00, orar kur ka përfunduar procesi mësimor për shkollat që zhvillojnë mësimin në turnin e dytë. Nga kontakti me drejtoritë e shkollave nuk rezultoi që të jenë larguar nxënës nga procesi mësimor, për tu bërë pjesë e ndonjë veprimtarie të caktuar elektorale ose jo”.

Më datë 28.4.2023, bashkia Durrës sqaron në lidhje me denoncimin **nr. 356 ID dhe 342 ID** “Nga takimet me maturan të, votues për herë të parë dhe nxënës të shkollave të mesme të qytetit: “Gjergj Kastrioti”, “Naim Frashëri” dhe “Leonik Tomeo” për të diskutuar për projektet e realizuara dhe për ato që do të bëjmë gjatë mandatit të ardhshëm 4 vjeçar”, nuk ka cënuar aspak mbarëvajtjen e procesit mësimor të këtyre nxënësve, votues për herë të parë në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, e konfirmuar kjo dhe nga ZVAP Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar. Sqarojmë se aktiviteti i organizuar me nxënësit e Shkollës së Mesme “Leonik Tomeo” është zhvilluar në orën 13:30, duke qënë se orari mësimor përfundon në orën 13:05, ndërsa aktiviteti i organizuar me nxënësit e shkollave të mesme “Gjergj Kastrioti” dhe “Naim Frashëri” është zhvilluar në orën 18:00 dhe 19:00, duke qënë se orari mësimor përfundon në 17:25 për shkollën e mesme “Gjergj Kastrioti” dhe 17:40 për shkollën e mesme “Naim Frashëri”. Sqarojmë se këto aktivitete janë zhvilluar në ambiente publike që frekuentohen nga grup moshë të ndryshme.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 5.5.2023, ora 12:30, ku u ftuan në këtë proces palët për denoncimin me **nr. 342 dhe 344 dhe 356 ID**, duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në seancë u paraqit përfaqësuesi të gjitha palët. Përfaqësuesi i ZVA Durrës, gjatë seancës deklaroi se takimi i kryer nuk kanë cënuar procesin mësimor dhe janë kryer jashtë ambienteve të shkollës. Përfaqësuesi i bashkisë ju qëndroi pretendimeve të ZVA.

Denoncuesi gjatë seancës pretendoi se pala e denoncuar duhet të na provojnë për orarin kur është kryer aktiviteti, pasi nga fotografitë duket qartazi që është zhvilluar gjatë orarit të procesit mësimor.

Në përfundim të hetimit administrativ për denoncimin me **nr. 342 dhe 356 ID**, vlerësoj se: Referuar neni 91, pika 2, të Kodit Zgjedhor paashkohet se “Me përdorim të “burimeve

njerëzore” kuptohet **përdorimi i detyruar** në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe **përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar** në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim. I njëjti përcaktim bëhet edhe në nenin 3, pika 1, nëndarja 1.3, shkronja “ç” e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Vlerësoj se, që të konstatohet shkelja duhet të vërtetohet **“përdorimi i detyruar”** dhe **“organizmi i aktivitetit brenda orarit mësimor”**, si dhe **premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë**, ose **nxënësve** për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore **jashtë orarit të punës ose mësimin**, si dhe **ushtrimi i presionit ndaj tyre** për këtë qëllim

Gjatë hetimi administrativ, bazuar në provat e vëna në dispozicion nga denoncuesi dhe referuar prapsimeve të ZVA Durrës dhe bashkisë Durrës, nuk u arrit të provohej për sa kërkohet nga ligji, si kusht për të konstatuar shkeljen administrative. Për sa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ për denoncimin me nr. 342 ID dhe 356 ID ,duke mos konstatuar shkeljen e pikës 2, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe neni 3, pika 1, nëndarja 1.3, shkronja “ç” e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

3. Denoncimet e regjistruara ndaj Kryetarit/Kandidatit të bashkisë Rrogozhinë z. Edison Memolla. Denoncuesit pretendojnë se z. Memolla ka ushtruar presion ndaj mësuesve që refuzojnë të marrin pjesë në takimet elektorale të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Për të njëjtin subjekt dhe objekt, kanë ardhur 2 (dy) denoncime të regjistruara **me nr. 362 ID**, me kërkues z. Ivi Kaso dhe **me nr. 345 ID**, me kërkues zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

- **Denoncimi nr. 362 ID**, me kërkues z. Ivi Kaso, nëpërmjet shkresës nr. 143 prot., datë 20.4.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4145 prot., datë 24.4.2023 ku pretendohet se *“Në datë 20.04.2023, në faqen elektronike Ballkan Ëeb është publikuar denoncimi nga kandidati i Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për bashkinë Rrogozhinë, ku vërtetohet presioni dhe kërcenimi i vazhdueshëm që u bëhet mësuesve, që refuzojnë që të marrin pjesë në takimet elektorale të PS, të cilët kërcenohen me largim nga puna”*.
- **Denoncimi nr. 345 ID**, me kërkues zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet ndërfaqes së denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 10997, i datës 20.4.2023 ku pretendohet i njëjti fakt si në denoncimin **nr. 362 ID**.

Më datë 28.4.2023, Zyrës Vendore Arsimore Rogozhinë dhe bashkisë Rogozhinë i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 2.5.2023 ZVA Rogozhinë është na ka informuar se *“Nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Rogozhinë, në asnjë moment nuk është ushtruar presion, apo kërcënim ndaj punonjësve të arsimit nën juridiksionin e ZVAP Rogozhinë, për pjesëmarrjen në takimet elektorale të subjektit zgjedhor PS, si kundër pretendon denoncuesi kandidat i koalicionit “Bashkë Fitojmë”.*

Nëpërmjet shkresës nr. 1655 prot., datë 27.4.2023 e administruar pranë nesh me shkresën nr. 4462 prot., datë 2.5.2023 bashkia Rogozhinë ka sqaruar se *“Bashkia Rogozhinë kundërshton këto pretendime pasi aktiviteti është organizuar nga vetë kjo bashki dhe jo nga subjekti politik “Partia Socialiste”. Ky takim është realizuar për të prezantuar përpara pjesëmarrësve punën e kryer gjatë viteve të fundit nga bashkia Rogozhinë në shkollat dhe kopshtet që janë ndërtuar nga e para apo janë rikonstruktuar. Duke qenë se bashkia është njësi përgjegjëse për infrastrukturën shkollore dhe mirëmbajtjen e saj, gjatë gjithë takimit është diskutuar për këtë çështje duke mirëpritur sugjerimet e atyre që punojnë cdo ditë në këto institucione, por në asnjë moment nuk ka pasur diskutime dhe reklamime për kandidatin apo partinë dhe aq më pak të bëhen presione apo kërcënime për të larguar nga puna punonjës të arsimit. Z. Edison Memolla ka marrë pjesë dhe ka drejtuar këtë aktivitet në cilësinë e kryetarit të bashkisë Rogozhinë dhe jo si kandidati për kryetar bashkie nga subjekti politik përkatës. Në këto kushte bashkia Rogozhinë kundërshton pretendimet e zj. Albana Vokshi dhe koalicionit “Bashkë Fitojmë” si të pavërteta. Bashkangjitur po ju dërgojmë kopje të prezantimit të shkollave dhe kopshteve që kryetari i bashkisë Rogozhinë Z. Edison Memolla ka prezantuar dhe diskutuar me pjesëmarrësit.*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 5.5.2023, ora 12:30, ku u ftuan në këtë proces palët, duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në seancë nuk pati të përfaqësuar të bashkisë Rogozhinë.

vlerësoj se: Referuar neni 91, pika 2, të Kodit Zgjedhor paashikohet se *“Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet **përdorimi i detyruar** në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe **përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar** në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.* I njëjti përcaktim bëhet edhe në nenin 3, pika 1, nëndarja 1.3, shkronja “ç” e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Vlerësoj se, që të konstatohet shkelja duhet të vërtetohet **“përdorimi i detyruar”** dhe **“organizmi i aktivitetit brenda orarit mësimor”**, si dhe **premtimi ose ofrimi i përfitimeve**

nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore **jashtë orarit të punës ose mësimi**, si dhe **ushtrimi i presionit ndaj tyre** për këtë qëllim

Gjatë hetimi administrativ, bazuar në provat e vëna në dispozicion nga denoncuesi dhe referuar prapsimeve të ZVA Rrogozhinë dhe bashkisë Rrogozhinë, nuk u arrit të provohej për sa kërkohet nga ligji, si kusht për të konstatuar shkeljen administrative. Veprimtaria e kryer rezultoi të ishte një veprimtari ndërinstitucionale midis bashkisë dhe shkollave të kësja bashkie. Për sa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ për denoncimin me nr. 362 ID dhe 345 ID ,duke mos konstatuar shkeljen e pikës 2, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe neni 3, pika 1, nëndarja 1.3, shkronja “ç” e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

4. Denoncimin e regjistruar me nr. 355 ID ndaj Bashkisë Kuçovë/kryetarit të bashkisë z. Kreshnik Hajdari, me kërkues z. Ivi Kaso, për përdorimin e aseteve publike (burime njerëzore), për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 355 ID**, me kërkues z. Ivi Kaso, "*Kreshnik Hajdarit, kandidat i Partisë Socialiste në bashkinë e Kuçovës ka përfshirë në fushatën e tij elektorale shumë punonjës të bashkisë Kuçovë si dhe institucioneve të tjera publike. Më poshtë lista e 16 punonjësve të administratës publike të përfshirë në fushatë, i listruan në foto:*
 - Sybi Shehu, nën kryetar i bashkisë Kuçovë;*
 - Shkëlqim Braushi Drejtor i ASHK-së Kuçovë;*
 - Sajmir Plaku, drejtor i Drejtorisë së Transportit Rrugor Berat;*
 - Gentjan Qafoku, Drejtor i Fabrikës Mekanike Kuçovë (pothuajse në çdo aktivitet);*
 - Bardhi Sula, nënprefekt i Kuçovës;*
 - Renata Baci, Administratore e Bashkisë Perondi;*
 - Egla Veria, mësuese e historisë në gjimnazin e Kuçovës;*
 - Nazmi Sula, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë në Bashkinë Kuçovë, i cili më parë ka qenë drejtor i Ujësjellësit Kuçovë për 7 vjet;*
 - Taulant Demaj, operator i sistemit të transmetimit OSHE - Bashkëshortja e Taulantit që punon në bashkinë e Kuçovës*
 - Mariglen Gjika, punonjës në bashki dhe drejtues i shtabit zgjedhor të Kandidatit*
 - Jona Koraqe, punonjëse e Bashkisë Kuçovë*
 - Marjano Prifti, punon në fabrikën Mekanike Kuçovë*
 - Adri Dajko, punon në fabrikën Mekanike Kuçovë*

-Ylli Bejto Drejtor i Sektorit të Përpunimit të Naftës në Ndërmarrjen e Naftëprodhimit

-Aleksandër Ziu, inxhinier pranë Fabrikës Mekanike Kuçovë

Provat: Fotot në rrjetet sociale zyrtare të kandidatit <https://infront-al.com/dreit-burgut-hajdari-i-bashkise-kucove-vodhi-varrezat-tenderin-e-qenve-tenderin-e-gjelberimit-dhe-se-fundmi-i-ben-presion-administrates-per-pjesmarrje-ne-fushate-elektorale/>

Më datë 27.4.2023 kryetarit të bashkisë, njëkohësisht kandidatit z. Kreshnik Hajdari i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 27.4.2023 nga bashkia Kuçovë jemi informuar se **“Së pari, denoncimi përmban pasaktësi të mëdha në gjeneralitetet e personave të denoncuar dhe vendet ku punojnë, pozicionet etj. Së dyti, në vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, parashikohet se “punonjësi i administratës shtetërore pas orarit të punës kanë të drejtë të marrin pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një subjekti zgjedhor apo kandidati. Së treti, nuk ka pasur asnjë përdorim i detyruar për pjesëmarrje në këto aktivitete apo presion mbi administratën. Nuk ka asnjë provë për këtë. Së katërti, një pjesë të personave të lartë përmendur janë pjesë e aktiviteteve për shkak të pozicioneve në Partinë Socialiste të Shqipërisë dhe nuk janë pjesë e shërbimit civil”**.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 5.5.2023, ora 12:30, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga bashkia Kuçovë.

Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësoj se bazuar në nenin 91, pika 2, të Kodit Zgjedhor dhe të nenit 3, pika 1, nëndarja 1.3, shkronja “ç” e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator ku parashikohet se konsiderohet veprimtari e ndaluar: **“përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim”**. Vlerësoj se, që të konstatohet shkelja duhet të vërtetohet **“përdorimi i detyruar”** i administratës dhe orari kur kanë qenë pjesëmarrës.

Referuar nenit 6, të vendimit nr. 9 datë, 24.12.2020, të Komisionit Rregullator **“Punonjësi i administratës shtetërore, vetëm pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.”** Gjatë hetimit administrativ nuk u arrit të provohej orari i kryerjes së këtyre veprimtarive dhe “pjesëmarrja e detyruar” e tyre. Për sa më sipër, vlerësojmë se duhet të

Data:10.5.2023 Nr: 481
Ora: 13:30



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 21 Prill – 27 Prill 2023”

pushohet hetimi administrativ për denoncimin me nr. 355 ID duke mos konstatuar shkeljen e pikës 2, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor.

5. Denoncimin e regjistruar me nr. 363 ID ndaj Bashkisë Lushnje, me kërkues z. Ivi Kaso, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 363 ID**, me kërkues z. Ivi Kaso, "Në datë 27-28 Prill, Bashkia Lushnjë ka njoftuar zhvillimin e veprimtarisë publike (Panairin "Ditët e Bujqësisë"), i cili në kundërshtim me legjislacionin sa më lartë për aktivitetet publike në kohë fushate, nuk është pajisur as me leje zhvillimore për këtë aktivitet. Kujtojmë se kryetarja e bashkisë Lushnje Eriselda Sefa, u gjobit nga KAS disa ditë më parë për mbajtjen e të tilla aktiviteteve në periudhën para zgjedhore të 14 Majit."


Më datë 28.4.2023 bashkisë Lushnje i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike, dhe kjo bashki bën me dije se "Aktiviteti "Panairi Ditët e Bujqësisë 2023" u rikthye në qytetin e Lushnjës në datat 27-29 Prill 2023. Ky panair ndërkombëtar u organizua nga Iceberg Exhibitions, në bashkëpunim me bashkinë Lushnje, me një fokus më të gjerë në sektorët e bujqësisë, blegtorisë, peshkimit, inovacionit, ushqimit dhe përpunimit. Është viti i dytë radhazi që organizohet dhe është aktivitet i parashikuar më herët si në kalendarin e aktiviteteve të vitit 2023, ashtu dhe në buxhetin e miratuar në Dhjetor të vitit 2022 për vitin pasardhës. Përcaktimi i datave të zhvillimit kryhet nga organizatorët Iceberg Exhibitions. Në muajin Shkurt ky aktivitet është raportuar dhe në KQZ, link-et më poshtë:

<https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/16/panairi-ditet-e-bujqesise-2023/>
<https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/16/panairi-ditet-e-bujqesise-2023-2/>
<https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/16/panairi-ditet-e-bujqesise-2023-3/>
Bashkëlidhur do të gjeni dokumentacion shkresor të nevojshem.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 5.5.2023, ora 12:30, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por në pamundësi për tu paraqitur, bashkia Lushnje, mbështet edhe një herë pretendimet e saj nëpërmjet postës elektronike. Ndërsa nga pala denoncuese nuk u paraqit asnjë përfaqësues në seancë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve në denoncimin e regjistruara me nr. 363 ID rezultoi se:

Referuar të dhënave të deklaruara në ndërfaqen e raportimeve, aktiviti i bashkisë Lushnje është konsideruar i lejuar për t'u zhvilluar, në kuptim të nenit 3, të vendimit, nr. 9, datë 24.12.2020, të

Komisionit	Rregullator.	Nga	verifikimi	i të dhënave dhe fakteve aktiviteti i
	Data:10.5.2023 Nr: 481 Ora: 13:30			"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 21 Prill – 27 Prill 2023"

zhvilluar nga bashkia Lushnje nuk u konstatua shkelja e nenit 91, dhe as të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Përsa më sipër, nga verifikimi i të dhënave në ndërfaqen e raportimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se bashkia Lushnje ka përmbushur detyrimin për raportim të parashikuar nga neni 92, të Kodit Zgjedhor, brenda afateve ligjore. Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti për këto denoncime nuk përmban elementë për konstatimin e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator ‘Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrative të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

V E N D O S:

1. Moskonstatimin e shkeljes administrative për raportimet e kryera në shkelje të afatit ligjor.
2. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:
 - a) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit,
 - b) Ministria e Kulturës,
 - c) Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes,
 - ç) Këshilli i Qarkut Vlorë,
 - d) Bashkia Kolonjë,
 - dh) Bashkia Korçë,
 - e) Bashkia Pogradec
3. Moskonstatimin e shkeljes dhe pushimin e hetimit administrativ ndaj:
 - Zj. Festime Mjeshtri, kandidat për kryetar në bashkinë Bulqizë;
 - Zj. Emiriana Sako, kandidat dhe kryetar i bashkisë Durrës;

Data:10.5.2023 Nr: 481
Ora: 13:30



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 21 Prill – 27 Prill 2023”

- Z. Edison Memolla, kandidat dhe kryetar i bashkisë Rogozhinë;
 - Z. Safet Gjici, kandidat dhe kryetar i bashkisë Kamëz;
 - Z. Kreshnik Hajdari, kandidat dhe kryetar i bashkisë Kuçovë;
 - Zj. Eriselda Sefa, kandidat dhe kryetar i bashkisë Lushnjë.
4. Përcjelljen për kompetencë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, denoncimin e regjistruar me numër nr. 343 ID dhe 361 ID, ndaj zj. Festime Mjeshtir, Drejtor i Shërbimit Spitalor Bulqizë.
 5. Ky vendim t'u njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI